



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2020

Lënda: Informacion në lidhje me funksionimin e Qendrave Komunitare “Për Familjen”

_____, Shkodër

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, administruar me nr. 3797 prot. datë 27.2.2020, ju informojmë si më poshtë:

Bashkia Shkodër duke vlerësuar domosdoshmërinë e bashkëpunimit të të gjithë aktorëve për adresimin sa më të mirë të nevojave të të miturve në kontakt me ligjin dhe me qëllim institucionalizim e këtij bashkëpunimi ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë.

Objekt i kësaj Marrëveshje është vendosja e bashkëpunimit mes sy institucioneve (Bashkia dhe Shërbimi i Provës) për realizimin dhe mbikqyrjen e masave alternative të shmangies nga ndjekja penale për të miturin në konflikt me ligjin. Sipas pikave që ju parashtrova :

1. Deri tani ka vetëm një rast për të cilin është vendosur me Vendim nr. 5731 datë 05.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër: “Zbatimi i masës së shmangies nga ndjekja penale për të miturin S.P” , banor i njësisë administrative Rrethina.

Në zbatim të këtij vendimi ne bashkëpunim me Shërbimin e Provës janë ndjekur të gjitha procedurat për trajtimin e rastit me qëllim zbatimin e masës alternative të vendosur nga Gjykata që është “...përfundimi i shkollës së mesme të përgjithshme dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e provës...”

Pas takimit të Grupit teknik Ndërsektorial, është hartuar Plani individual i Ndërhyrjes dhe në bashkëpunim me Shërbimin e Provës është hartuar Kalendari i Monitorimit të zbatimit, i cili vazhdon të ndiqet nga dy strukturat dhe në bashkëpunim me shkollën përkatëse, deri në përfundimin e shkollës nga i mituri.

2. Marrëveshje, ndër të tjera ka si qëllim trajtimin edhe përfshirjen e të miturve në konflikt me ligjin në shërbimet dhe aktivitetet që realizohen në Qendrat Komunitare « Për familjen » të Bashkisë Shkodër. Nevojat për shërbime sociale ku përfshihen edhe shërbimet sociale për fëmijët në konflikt me ligjin janë reflektuar në Planin Social të Zonës, të miratuar.

3. Në përgjigje të nevojave për shërbime sociale dhe me qëllim shtrirjen e shërbimit social në territor sa më pranë komunitetit, Bashkia Shkodër ka ngritur rrjetin të shërbimit social në komunitet me Qendrat Komunitare “Për familjen”, që janë 12 deri tani, të shtrira në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Përfitues të shërbimeve sociale në këto qendra janë të gjithë individët, familjet, të miturit ku përfshihen dhe të miturit në konflikt me ligjin si dhe kategoritë e tjera të personave në nevojë të përcaktuar sipas kuadrit ligjor.

4. I gjithë dokumentacioni (Plani Individual i ndërhyrjes, vleresimet, kalendari i monitorimit, proces verbale të takimeve të realizuar), sa i takon rastit për të cilin është vendosur “Shmangja nga ndjekja penale” janë pjesë e dosjes të të miturit që administrohet nga Q. K. “Për Familjen”, Rrethina, që ndjek rastin në bashkëpunim me Shërbimin e provës.

5. Së fundmi me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 367 datë 15.07.2019 “ Për miratimin e Formatit të Planit Individual për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga Gjykata për të miturin në konflikt me ligjin”, i cili do të jetë një dokument ku do të referohemi për rastet në vijim për planifikimin e punës në bashkëpunim me Shërbimin e Provës për fëmijët në konflikt me ligjin.

6. Bashkia Shkodër ka në fokus të punës së saj dhe realizimin e aktiviteteve ndërgjegjesuese me qëllim parandalimin e fenomeneve negative që hasen tek të miturit siç janë fëmijët në konflikt me ligjin si dhe promovimin e shërbimeve që ofrohen duke përfshirë dhe kategorinë e të miturve në konflikt me ligjin.

Me qëllim përfshirjen e të miturve dhe të rinjve në konflikt me ligjin në aktivitete edukuese dhe sociale, bashkëpunojmë edhe me Qendrën Rinore Atelie, e cila i dedikohet përfshirjes edukative, artistike, sociale dhe kulturore të të rinjve, duke krijuar hapësirat e nevojshme dhe aksesin në sipërmarrje, kulturë, art, teknologji informacioni, etj.

Një tjetër kategori po aq e rëndësishme që trajtohet nga Bashkia Shkodër me prioritet janë dhe të miturit nën moshën për përgjegjësinë penale, që dyshohet apo ka kryer veprë penale. Nga qendrat tona komunitare janë trajtuar disa raste të tilla të cilat paraqiten shumë problematike sepse në shumicën e rasteve nuk kemi bashkëpunimin e familjes. Këto raste trajtohen sipas protokollit të mbrojtjes së fëmijëve.

Duke ju falenderuar, shprehim gadishmërinë e bashkëpunimit me të gjitha strukturat publike dhe jo publike për të adresuar sa më mirë nevojat në trajtimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin dhe jo vetëm.

Me respekt,

KRYETAR

Voltana Ademi